



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 373, datë 28.09.2020

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}

DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR DY POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 86 DHE NR. 87, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 28.09.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës, të kandidatit për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, z. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

2. Në këtë rast afati i kandidimit është përcaktuar “dy muaj nga dita e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3. Vendimi i Këshillit si më lart është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, duke filluar të ecin afatet e kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020.

4. Aktualisht kanë përfunduar afatet e pezulluara¹ dhe më pas të zgjatura² të kandidimit për të dyja procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të hapura me vendimet e sipërcituara.

5. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, ka kandiduar edhe gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

6. Me Vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020”, Këshilli ka vendosur:

1. *Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. *Caktimin e relatorit si më poshtë:*

1. *Për kandidatin z. {...} – relatore znj. Marçela Shehu.*

7. Më datë 12.06.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 17.06.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidati duhet ta dorëzonte, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 08.07.2020, pranë ILDKPKI-së. Kjo e fundit nuk e ka njoftuar Këshillin, sikundër i është kërkuar, në rastin e mospërbushjes së këtij detyrimi nga ana e kandidatit, çka nënkupton dorëzimin nga kandidati të formularit të deklaratës së pasurisë.

¹ Më datë 12.03.2020.

² Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020.

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 25.06.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}.

12. Në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr. 86, datë 26.02.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”³, “c”⁴ dhe “ç”⁵, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që janë kriteri i *“përvojës profesionale minimale”*, i *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”* dhe i *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin z. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

13. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të përmendur më lart në fushën e të drejtës civile, Këshilli me Vendimin nr. 246, datë 09.07.2020, ka vendosur:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86, datë 26.02.2020....”.

14. Ndërkohë, me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

...

³ Në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 86, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

⁴ Në shkronjën “c” të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*

⁵ Në shkronjën “ç” të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

3. Afati i kandidimit është pesë muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

15. Vendimi e Këshillit si më lart për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020, duke përfunduar ky afat në datë 30.07.2020.

16. Brenda afatit të kandidimit për këtë pozicion të lirë, ka kandiduar edhe gjyqtari z. {...}.

17. Aktualisht kandidati është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, e cila po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht me këtë procedure të verifikimit të pasurisë dhe të figurës së këtij kandidati në kuadër të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

18. Ndërkohë, mbas përfundimit të afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile sipas pikës 1 të këtij vendimi, Këshilli, me Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020 (të plotësuar me vendimin nr. 271 datë 26.08.2020), vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura, ndër të tjerë, edhe me vendimin në fjalë⁶. Në këtë rast, sipas këtij vendimi⁷, procedurat e verifikimit për kandidatët të cilët kishin kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, do të vijonin të kryheshin nga të njëjtët relatorë, bazuar kjo në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit 75/2019, ku përcaktohet se: *“Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”*. Referuar këtij përcaktimi, në pikën 4 të vendimit, Këshilli vendosi që për kandidatin z. {...}, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime (*nënkupto këtu Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020*), është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë, të shpallur me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020.

19. Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020.

20. Sa i përket verifikimit të plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020, pra të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në kushtet kur kandidati është verifikuar për plotësimin e këyre kriterëve në kuadër të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në të njëjtën

⁶ Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020.

⁷ Vendimi nr. 268, datë 07.08.2020.

fushë të së drejtës, pra atë civile⁸, u çmua se nuk kishte vend për kërkimin dhe administrimin përsëri të të njëjtit dokumentacion zyrtar, duke qenë i vlefshëm për qëllimet e këtij verifikimi dokumentacioni i administruar më parë. Gjithsesi, për kriteret e “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” u kryen disa veprime verifikuese, sikurse do të përshkruhen më poshtë, në funksion të verifikimit të ekzistencës së ndonjë të dhëne të ndryshme nga sa më parë, kjo për shkak se këto rrethana janë potencialisht të ndryshueshme qoftë edhe në një kohë të shkurtër.

21. Kandidati z. {...}, sikurse më herët, edhe në rastin e kandidimit për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, ka kandiduar për të njëjtën fushë të së drejtës, atë civile dhe për rrjedhojë, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me këtë vendim, ai rezulton të ketë mbi trembëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar me mbi 13 vjet në gjykatat e nivelit më të ulët, nga të cilat mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile”.

21.1 Ndërkohë, pra mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 246, datë 09.07.2020, nuk rezulton që ndaj kandidatit të jetë marrë ndonjë masë disiplinore⁹. Për rrjedhojë, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

21.2 Gjithashtu, nuk rezulton ekzistenca e ndonjë rrethane të ndryshme nga sa është konstatuar më parë në lidhje me qenien e kandidatit z. {...} në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 246, datë 09.07.2020.

22. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira të përmendura më lart në fushën e të drejtës administrative, Këshilli me Vendimin nr. 350, datë 24.09.2020, ka vendosur:

- 1. Verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*
- 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020.....”*

⁸ Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020.

⁹ Referuar nenit 105 të Ligjit për Statusin vendosja e masës disiplinore ndaj gjyqtarit është kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

23. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS

24. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: “7. *Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.* 8. *Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

25. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera edhe në Gjykatën e Lartë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019). Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

26. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016”, përcaktohet se: “1. *Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, do t’i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.* 4. *Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. ... 6. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, fillojnë pas afatit 180 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të Ligjit nr. 9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë.* 7. *Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së*

verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.

27. Sa sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidatit që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar.

28. Rezulton se kandidati, z. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 79, datë 22.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat u shtri për periudhën pas datës 30.01.2019, që ka marrë formë të prerë vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tij në detyrë.

28.1 Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson kriteret e kandidimit/emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 48 të Ligjit të Statusit.

A. Për kriterin e pasurisë

29. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32¹⁰, të Ligjit për Statusin, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

30. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë

¹⁰ “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 2353/1 prot., datë 21.07.2020.

30.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

30.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

31. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

31.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Tajonale Tatimore Gjirokastër informacioni u dërgua me Shkresën nr. 1704/2 prot., datë 15.07.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2837/19 prot., datë 17.07.2020, ku për kandidatin {...} nuk rezulton të jetë i regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

31.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 1456/1 prot., datë 18.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 14256/1 prot., datë 18.08.2020, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

32. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidatin, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

33. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe private, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, nuk u konstatua paplotshmëri ose mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

34. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B. Për kriterin e figurës

35. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit.

36. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi vetëm së fundmi Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit¹¹, ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni¹².

37. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

38. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, në kushtet kur ky kandidat ka qenë magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

39. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 2837/1 prot., datë 18.06.2020, ku për kandidatin {...} është bërë me dije se:

- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 25.04.2016;
- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web;
- në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji;
- nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, ka rezultuar ndryshim i të dhënave të gjendjes civile, nga ato të deklaruara, pasi në aktin e lindjes nr. 181 datë 21.09.1978, emri i nënës rezulton {...}, deklaruar {...}. Ky informacion është dërguar për verifikim pranë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka kthyer përgjigje, ... se Sektori i Verifikimit të

¹¹ Vendimi nr.183, datë 30.07.2020.

¹² Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

Integritetit kryen verifikime të thelluara në lidhje me vendime dënimi përfundimtarë apo jo, hetime, dëbime apo masa sigurimi penale të kryera brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë dhe nëse kërkoni këtë dërgoni informacion në lidhje me indiciet për të kaluarën kriminale të subjekteve dhe arsyen pse kërkohet ky verifikim...;

- deri më sot nuk ka patur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

40. Kandidati z. {...} nuk iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai nuk është i vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidati është i vitlindjes 1978), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019.

41. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë për emërim si gjyqtar.

III. KONKLUZIONE

42. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

43. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e

lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

3. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020.
4. Vendimet nr. 246, datë 09.07.2020 dhe nr. 350, datë 24.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR